



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesja **Sonila Sula** me datë **17.10.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Zëvendësimin e masës së sigurimit *“arrest në shtëpi”* parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, dhënë nga Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj të pandehurës Sonila Sula”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Erjon Çela, Erjon Bani dhe Rudina Palloj, bazuar në nenin 112 dhe 260/2 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **587**, datë **28.10.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkueses, (të pandehurës) **Sonila Sula**.
2. Zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëgues atë të *“arrest në shtëpi”* e caktuar ndaj kërkueses, të pandehurës, Sonila Sula, me vendimet Nr. 70, datë 23.06.2023 dhe Nr. 79 datë 28.06.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me masën e sigurimit personal *“Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”* e parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.
3. Urdhërohet kërkuesja, (e pandehura), Sonila Sula që të paraqitet në Zyrat e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pranë oficerit të Policisë Gjyqësore pranë kësaj prokurorie, të hënën e parë të çdo muaji në orën 12:00.
4. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe shërbimet e policisë gjyqësore me zbatimin e këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 5 ditëve, afat i cili fillon nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës.

Tiranë, më datë 28.10.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar